



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË - DEGA E GJYKATËS ISTOG

Numri i lëndës: 2020:059639

Datë: 13.07.2020

Numri i dokumentit: 01020443

P.nr.104/20

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NE PEJE –DEGA ISTOG – DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM-Divizioni Penal, sipas gjyqtarit të vetëm gjykues Arben Mustafaj, me pjesëmarrjen e sekretares juridike Hale Ahmetaj, në lëndën penale kundër të pandehurit B.F nga fsh. K. K. I... , i akuzuar për vepër penale, “Dhunë ne familje” nga neni 248 par.2, lidhur me par.1 të KPRK-së, duke vendosur sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore ne Pejë – Departamenti i Përgjithshëm PP/II.nr.415/20,e dt.15.04.2020, në seancën publike të shqyrtimit fillestar të mbajtur me **08.07.2020**, në praninë e Prokurorit te shtetit Suada Hamza, të pandehurit B. F. , të dëmtuarës Q. S., si dhe mbrojtëses se viktimave Saime Sylaj, Gjykata të njëjtën ditë mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me dt.13.07.2020 e përpiloj këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri **B. F.** , i lindur me ne I..., tani me banim ne fsh. K. K. I..., i biri i E. dhe nenës F. e gjinisë M., i martuar, babai i 3 fëmijëve, ka te kryer shkollën e mesme, punëtor krahu, i gjendjes se dobët ekonomike, i identifikuar ne bazë të letërnjoftimit me nr....., Shqiptar, Shtetas i Republikës se Kosovës, i pa dënuar me parë nga Gjykata, gjendet ne liri.

ËSHTË FAJTOR

Për shkak se:

Me date, rreth orës, ne shtëpinë e tij e cila gjendet në rr. "Zh. Gj. ne fshatin K. K. I..., brenda marrëdhënies familjare me qellim te cenimit te dinjitetit ushtron keqtrajtim psikologjik dhe fizik ndaj viktimës se ndjeshme Q. S. me te cilën bashkëjeton qe shtate vite, dhe kanë tre fëmijë, ne atë mënyrë qe përderisa viktimja ishte e shtrire, e njëjta pranon një telefonat nga nëna e saj, ku përgjigjet vajza e tyre dhe viktimja i thotë se është e lodhur dhe duke fjetur, i pandehuri i drejtohet me fjalët "çfarë nëne je ti kur fletë deri ne atë ore, dhe kur viktimja ia kthen "çfarë burri je ti kur fletë deri ne orën 10:00 dhe 11 :00, e nuk del te punosh", i pandehuri nga nervoza ngritët duke e goditur me rrip ne te gjithë trupin,

- me çka ka kryer vepër penale, “ dhuna ne familje” nga neni 248 par. 2, lidhur me par. 1 te KPRK-se.

Gjykata, duke vendosur në kuptim të nenit 7,8,9,10,17,21,38,40,42,43,46,47,48,49, 69,70, si dhe neni 248 par.2 lidhur me par.1 të KPRK-së, dhe nenit 359, 360, 361, 365, 366,450 te KPPRK-së, i shqipton.

DËNIM ME KUSHT:

Ashtu qe:

1. Të pandehurit **B. F.**, gjykata i shqipton dënim me gjobë ne shumë prej **600 (gjashtëqind)** euro dhe dënim me burgim në kohëzgjatje prej **6 (gjashtë) muajsh**, te cilat dënime nuk do të ekzekutohen nëse i pandehuri në afatin ligjor prej **1 (një) viti**, pas plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi nuk kryen ndonjë veprë te re penale.
2. I pandehuri obligohet që në emër të paushallit gjyqësore te paguaj shumen prej **20 (njëzet) euro**, si dhe në emër të taksës për kompensimin e viktimave të krimit shumën prej **30 (tredhjet) euro** në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi.
3. E dëmtuara **Q. (Sh.) S. – F.** nga fsh. **K. K. Istogut**, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregullt juridiko-civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore ne Pejë– Departamenti i përgjithshëm, pranë kësaj Gjykate ka ngritë aktakuzën me PP/II.nr.415/20, e dt.15.04.2020, ndaj të pandehurit B.F nga fsh. K. K. Istog, duke e akuzuar për veprë penale, “Dhunë ne familje” nga neni 248 par.2, lidhur me par.1 të KPRK-së

Gjykata ka mbajtur shqyrtimin fillestar me dt.08.07.2020 në praninë e Prokurorit te Shtetit Suada Hamza, të pandehurit B. F. , te dëmtuarës Q. S., si dhe mbrojtëses se viktimave Saime Sylja.

Pas leximit të aktakuzës nga ana e prokurorit të shtetit i pandehuri B. F. deklaroi se e pranoi fajësinë për veprën penale për te cilën akuzohem, me vjen keq për rastin qe me ka ndodhur, i kërkoj falje publike këtu te dëmtuarës bashkëshortes sime, dhe i pretoj se asnjëherë nuk do te ketë probleme nga ana ime, tani me te njëjtën i kemi raportet e mira, jetojmë ne një shtëpi së bashku me tre fëmijët tonë, dhe familjen e ngushtë, jemi te martuar qe 7 vite, dhe asnjëherë me parë nuk kemi pasur mosmarrëveshje, mirëpo ka qene një moment, kur isha atë ditë nervoz dhe nuk i kontrollova veprimet e mija, është hera e parë qe bije ndesh me ligjin dhe ju pretoj se ne te ardhmen nuk do te bije ndesh me ligjin .

Gjykata kërkon mendimin e te dëmtuarës, prokurorit te shtetit dhe mbrojtëses se viktimave lidhur me pranimin e fajësisë se te pandehurit.

E dëmtuara deklaroi se pajtohet me pranimin e fajësisë te bere nga ana e te pandehurit, prej atij rasti nuk kemi pasur probleme ne mes veti, jetojmë së bashku ne një shtëpi me tre fëmijët tonë si dhe ma familjen e ngushte te B., nuk i bashkëngjitem ndjekjes penale ndaj bashkëshortit tim, nuk kërkoj ndonjë kërkesë pasurore juridike ndaj bashkëshortit tim, dhe kërkoj nga gjykata qe te njëjtit mos ti shqiptoj ndonjë dënim pasi qe i kemi rregulluar raportet ne mes veti, dhe ndaj tij e kam tërheq kërkesën për urdhër mbrojtje t e parashkruar ne këtë gjykate me dt. 20.03 2020.

Prokurori i shtetit pajtohet me pranimin e fajësisë, i cili pranim ka mbështetje ne provat qe gjenden ne shkresat e lendes, dhe është bere komfor dispozitave ligjore, i propozoj gjykatës qe te njëjtin te shpall fajtor dhe te dënoj sipas ligjit dhe ta obligoj ne pagesën e shpenzimeve procedurale, dhe me rastin e marrjes se vendimit mbi dënim, pranimin e fajësisë, si dhe pajtimin me te dëmtuarën nga ana e te pandehurit te merr si rrethanë lehtësuese, tek matja e dënimit.

Edhe mbrojtësja e viktimave deklaron: se pajtohem me pranimin e fajësisë të bere nga ana e te pandehurit dhe njehë rit e njoftoj gjykatën se e dëmtuara e ka tërheq kërkesën e saj për urdhër mbrojtje pasi qe janë pajtuar ne mes veti.

Pas deklarimit të pandehurit se e pranon fajësinë për veprën penale me të cilën akuzohet dhe mendimit të prokurorit të shtetit, të dëmtuarës si dhe mbrojtëses se viktimave se nuk e kundërshtojnë pranimin e fajësisë, Gjykata konstatoj se i pandehuri pranon fajësinë në mënyrë vullnetare dhe pa asnjë presion, i pandehuri është i vetëdijshëm për pasojat dhe përparësitë e pranimit të fajësisë, si dhe te gjitha kërkesat nga neni 248 par. 1 të KPPK-se janë përmbushur. Ashtu që gjykata me aktvendim në procesverbal aprovon deklarimin për pranimin e fajësisë nga ana e te pandehurit B. F. .

Duke pas parasysh se gjykata ka aprovuar pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit dhe ka vërtetuar se nuk ekziston asnjë rrethanë nga neni 253 par.1 pika 1.1, 1.2 dhe 1.3 të KPPK-së, si dhe faktin se janë plotësuar kushte nga neni 248 par.1 lidhur me par.4 të KPPK-së, atëherë në këtë çështje penale nuk është zhvilluar procedura e provave, mirëpo pas pranimit të fajësisë nga i pandehuri gjykata ka vazhduar me shqiptimin e dënimit.

Me faktet e ofruara në shkresat e lëndës, si dhe me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit Gjykata ka ardhë në përfundim se pandehuri B. F. , me date, rreth orës, ne rr. "Zh. Gj.", ne fshatin K. K. I..., pikërisht ne shtëpinë e tij, brenda marrëdhënies familjare me qellim te cenimit te dinjitetit ushtron keqtrajtim psikologjik dhe fizik ndaj viktimës se ndjeshme Q. S. me te cilën bashkëjeton qe 7 (shtate) vite, me te cilën ka 3 (tre) fëmijë, ne atë mënyrë qe, përderisa viktima ishte e shtrire, e njëjta pranon një telefonat nga nëna e saj , ku përgjigjet vajza e tyre dhe viktima i thotë se është e lodhur dhe duke fjetur, i pandehuri i drejtohet me fjalët "çfarë nëne je ti kur flenë deri ne atë ore, dhe kur viktima ia kthen "çfarë burri je ti kur flene deri ne orën 10:00 dhe 11 :00, e nuk del te punosh", i pandehuri nga nervozja ngritët duke e goditur me rrip ne te gjithë trupin,

Nga gjendja e vërtetuar faktike si është përshkruar në dispozitiv të aktgjykimit, pa dyshim rrjedhë se në veprimet e të pandehurit B. F., qëndrojnë të gjitha elementet e veprës penale “Dhunë ne familje “ nga neni 248 par.2 lidhur me par.1 të KPRK-së.

Sa i përket fajësisë gjykata ka gjetur se i pandehuri ka kryer veprën me dashje, pasi që ai ka qenë i vetëdijshëm për veprën penale dhe e ka dëshiruar kryerjen e saj.

Gjatë procedurës penale nuk janë paraqit rrethana të cilat do ta zvogëlojnë apo përjashtojnë përgjegjësin penale të pandehurit, kështu që i njëjti është penalisht përgjegjës për veprën penale me të cilën është akuzuar.

Duke vendosur lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit, gjykata i ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe renduese ne kuptim te nenit 69 dhe 70 te KPRK-se. Kështu si rrethana lehtësuese për te pandehurin, gjykata ka vlerësuar faktin se i njëjti kishte sjellje korrekte dhe e ka pranuar fajësinë për veprën penale me të cilën akuzohet, duke u penduar për veprën e kryer, është hera e parë qe bije ndesh me ligjin, të gjitha këto rrethana kjo gjykatë i ka pranuar si rrethana lehtësuese ne dobi te të pandehurit.

Rrethana renduese Gjykata ka gjete shkallën e lartë të pjesëmarrjes dhe prezencën e dhunës se së ushtruar ndaj viktimës se ndjeshme në këtë rast bashkëshortes se tij me të cilën jeton në mardh enjë familjare.

Gjykata ka ardhur ne përfundim se dënimi i shqiptuar te pandehurit është ne përputhje me shkallen e përgjegjësisë penale te tij dhe me intensitetin e rrezikimit te vlerave te mbrojtura te shoqërisë. Gjykata gjithashtu është e bindur se vendimi mbi dënim do te shërbej për arritjen e qëllimit te dënimit ne pengimin e te pandehurit ne kryerjen e veprave penale ne te ardhmen, por ai do te ndikoj edhe si preventive e përgjithshme për personat tjerë qe te përmbahen nga kryerja e veprave penale ne përputhje me nenin 38 te KPK-se.

Duke u bazuar ne nenin 450 par. 1 dhe 2 të KPPRK-së, gjykata ka përcaktuar paushallin gjyqësor si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vendimi për kompensimin e viktimave të krimit është marrë, konform nenit 39 par.3 nën par 3.1 të Ligjit nr.05/L-036 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Vendimi mbi udhëzimin e te dëmtuarës ne kontest civil është marrë konform nenit 463 par. 1. dhe 2. te KPPK-ës.

Nga arsyet e cekura më lartë dhe me zbatimin e nenit 370 të KPPK-së është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PEJË-DEGA ISTOG
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM
P.nr.104/20 me datë : 08.07.2020

Sekretarja Juridike

Hale Ahmetaj

Gjyqtari Gjykues

Arben Mustafaj

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi palët kanë te drejtë të parashetrojnë ankesë në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes. Ankesa i dërgohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë përmes kësaj Gjykate.